

V E N D I M
Nr.32, datë 22.7.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Hilmi Dakli,	Anëtari

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.7.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.36 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S : ZEF SHKJEZI, i përfaqësuar nga Av. Hajri Shehu.

SUBJEKT I INTERESUAR : MIRA KAURI, e përfaqësuar nga Av. Gëzim Lama.

O B J E K T I :

Deklarimi antikushtetues i Vendimit nr.590, datë 14.4.1994 i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit dhe të vendimeve gjyqësore të mëvonshme, pasi janë cënuar e drejta e pronës nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor, neni 38 të Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut”.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Me vendimin nr.135, datë 10.5.1946 të gjyqit arbitror të Gjykatës së Prefekturës Durrës, është vendosur pjesëtimi i pasurisë së luftshme dhe të palujtshme të trashëgimlënësit Gjon Zaja i vdekur në vitin 1943.

Vendimi i sipërm është marrë në bazë të Ligjit nr.66, datë 6.6.1945 “Mbi përfundimin me anë arbitrazhi të detyruar të çështjeve të varura pranë ish-gjykatave”, dhe mbasi ka marrë formën e prerë pjesët e pasurisë së pjeçstuar janë regjistruar në zyrën e ipotekave Durrës.

Mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë datë 15.3.1994 të kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.590, datë 14.4.1994 ka vendosur prishjen e vendimit Nr.135, datë 10.5.1946 të ish-gjykatës së Prefekturës Durrës dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e rrethit Durrës.

Në vendimin e tij kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit ndër të tjera ka pranuar se vendimi i Gjykatës së prefekturës nuk është vënë asnjëherë në ekzekutim.

Mbi bazën e këtij vendimi të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, çështja është rigjykuar për fazën e parë të pjesëtimin dhe vendimi ka marrë formën e prerë. Gjithashtu, gjykata e rrethit Durrës, me vendimin e fundit nr.1516, datë 3.5.1996, ka vendosur pjesëtimin në natyrë të pasurisë së palujtshme. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit.

Vendimi i sipërpërmendur nr.135, datë 10.5.1946 i Gjykatës së Prefekturës Durrës, është ekzekutuar po në vitin 1946, duke u bërë regjistrimi i pjesëve takuese në regjistrin e ipotekave.

Vetë fakti i shtetëzimit të pasurisë së palujtshme në vitin 1947 e në vitin 1950, i bërë në emrin e personit që i ishin caktuar në pjesë me vendimin e Gjykatës së Prefekturës, provon gjithashtu se ky vendim ishte ekzekutuar.

Transkriptimi i vendimit të gjykatës për pjesëtimin e pasurisë në zyrën e ipotekës bëhet kryesisht nga gjykata, kështu që nuk mund të pranohet regjistrimi vetëm pjesërisht i vendimit të gjykatës, në favor vetëm të njëres ose tjetres palë.

Pretendimi i përfaqësuesit të palës së interesuar se regjistrimi në zyrën e ipotekave është veprim i njëanshëm që nuk vërteton ekzekutimin e vendimit nuk qëndron ligjërisht sepse sipas dispozitave në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, sikurse edhe sot, zyra e ipotekave bën regjistrimin e vendimeve dhe ky regjistrim dëshmon plotësisht për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, pavarësisht

nga dorëzimi i sendit.

Në këto rrethana, Gjykata pranon se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit; vendimi nr.590, datë 14.4.1994 i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit dhe për rrjedhojë edhe vendimet e tjera gjyqësore të dhëna pas tij për këtë çështje vijnë në kundërshtim të hapur me nenin 184/2 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikonte se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në rast se

vendimi është ekzekutuar, mund të paraqitet vetëm brenda një viti nga dita e ekzekutimit të tij dhe si pasojë, çënojnë haptazi të drejtat e pronësisë së ankuesit me anë të një procesi jo të rregullt ligjor, duke u shkelur neni 38 mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

PER KETO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika

9 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, dhe nenit 38 të Ligjit Nr.7692, datë 31.3.1993 “Për liritë dhe të drejtat themelore të njëreut”, njëzëri,

V E N D O S I :

Të shpallë si antikushtetuese kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë datë 15.3.1994 të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit.

Të shfuqizojë si antikushtetues Vendimin nr.590, datë 14.4.1994 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Të shfuqizojë vendimin datë 10.8.1994 dhe nr.1516, datë 3.5.1996 të Gjykatës së Rrethit Durrës si dhe vendimet e mëvonshme të dhëna nga gjykatat e shkallëve të tjera më të larta të dhëna mbi ankim e rekurs.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më 22.7.1996